

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**  
**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve**

**PROGRAMI**  
**I KURSIT TË UNIFIKUAR**  
**SISTEME TË THATA NË NDËRTESTA**  
**Kodi: PK-B-6-20**

Miratoi:

MINISTRI

.....

Tiranë, 2020

# **PROGRAMI I KURSIT TË UNIFIKUAR**

## **“SISTEME TË THATA NË NDËRTEZA”**

**(PK-B-6-20)**

### **I. Profili Profesional i punonjësit të sistemeve të thata në ndërtesa**

#### ***a) Karakteristikat e punonjësit të sistemeve të thata në ndërtesa***

Punonjësi i punimeve të sistemeve të thata në ndërtesa do të jetë i aftë të kryejë detyra profesionale si i punësuar apo i vetëpunësuar në ndërmarrje ndërtimi, ose mbas një përvojë pune, krijon një biznes të vogël në punimet e sistemeve të thata në ndërtesa dhe punëson të tjerë në të.

Për realizimin me sukses të këtyre detyrave, punonjësi i punimeve të sistemeve të thata në ndërtesa duhet që të zotërojë njohuri profesionale që kanë të bëjnë me konceptet dhe procedurat bazë që lidhen me veprimtarinë profesionale të punonjësit të sistemeve të thata në ndërtesa.

Suksesi i punonjësit të sistemeve të thata në ndërtesa është i lidhur ngushtë dhe me *sjellje* (qëndrime) të tilla si: gjakftohtësia, shkathtësia, kujdesi, përqëndrimi, mospërdorimi i pijeve alkoolike, korrektesia, durueshmëria, disiplina etj., sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe përballojë vështirësitë e punës.

Punonjësi i punimeve të sistemeve të thata në ndërtesa koordinon punën me grupet e tjera për instalimet e ndryshme të infrastrukturës në tavan, si dhe me kolegë duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët.

Ai zbaton rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë, të ruajtjes së mjedisit dhe përmbush standardet e sigurimit të cilësisë për shërbimet e kryera.

#### ***b) Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale***

Profesioni i punonjësit të sistemeve të thata në ndërtesa është i lidhur ngushtë me procedurat e punës për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e llojeve të ndryshme sistemesh të thata brenda dhe jashtë ndërtimit. Ai mund të punësohet ose vetpunësohet në ndërmarrje publike apo private, në ndërmarrje prodhuese dhe të mirëmbajtjes të sistemeve të thata, ose duke krijuar një grup pune për aplikimin e punimeve të sistemeve të thata.

Me përvojë pune dhe me kualifikime shtesë mund të përparojë profesionalisht në nivelin e specialistit të sistemeve të thata në ndërtime. Më pas, nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale si specialist i sistemeve të thata në ndërtesa, apo trajnimit nëpërmjet punës, një specialist i sistemeve të thata në ndërtesa mund të ndërmarrë disa funksione mbikëqyrëse duke ngritur shkallët e karrierës si teknik i mesëm në këtë proces. Ndjekja e shkollës së lartë, çon në diplomimin e specialistëve të këtij profesioni në nivelin e inxhinierit të ndërtimit.

## **II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit “Sisteme të thata në ndërtesa”.**

Në përfundim të Kursit “Sisteme të thata në ndërtesa” kursantët do të jenë të aftë të:

- Përdorin dhe interpretojnë dokumentacionin teknik të projekteve të ndërtimit;
- Përdorin udhëzues – katalogë për mirëmbajtjen dhe riparimin e kartonxhesit.
- Përgatisin skica të thjeshta të realizimit të proceseve të punës në ndërtesë
- Realizojnë organizimin e vogël të punës.
- Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit në mjediset e punës.
- Realizojnë matje të përmasave me pajisjet dhe instrumentat matës.
- Përzgjedhin dhe përdorin mjetet, pajisjet, makineritë dhe materialet e duhura të punës.
- Mirëmbajnë mjetet, materialet, pajisjet dhe makineritë në mjedisin e punës.
- Zbatojnë procedurat e mirëmbajtjes së makinave sipas manualit të përdorimit dhe rregullave të sigurimit teknik
- Realizojnë punime për veshje elementësh strukturor dhe për muret ndarëse.
- Realizojnë nivelimin e strukturës metalike mbajtëse
- Realizojnë vendosjen e profileve në pikat e bashkimit të tavaneve të gipsit me sipërfaqe të tjera.
- Instalojnë profilet në fugat konstruktive të objektit sipas projektit.
- Realizojnë shërbime teknike të radhës.
- Realizojnë vendosjen e materialit izolues për izolimin termik/akustik.
- Realizojnë matje të profileve strukturore sipas formës së përcaktuar në projekt.
- Realizojnë hapjen e vrimave për instalimin e ndriçueseve ose instalimeve të tjera.
- Realizojnë punime të zëvendësimit, të mirëmbajtjes e të riparimit në elementeve të sistemeve të thata.
- Realizojnë montimin sipas projektit të kornizave këndore në bashkimin e murit me tavanin.
- Vendosin rozetat në tavane sipas projektit.
- Vendosin rrjetën në pikën e bashkimit të elementëve sipas projektit dhe kërkesës.
- Kryejnë punime në kolona dekorative sipas kërkesës dhe projektit.
- Kryejnë punime në elementë të tjerë dekorative (oxhaqe etj.) sipas kërkesës dhe projektit.
- Kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike për shërbimet duke zbatuar legjislacionin tatimor të fushës lidhur me aktivitetin.
- Kryejnë llogaritje lidhur me konsumin e materialeve gjatë procesit të punës, me dorë dhe / ose elektronike.
- Regjistrojnë të dhënat për faturat e lëshuara klientëve në regjistrimet e duhura
- Zbatojnë standardet e profesionit të punonjësit të sistemeve të thata.
- Respektojnë legjislacionin për profesionin duke përdorur terminologjinë e duhur profesionale.
- Komunikojnë me etikë me eprorët, kolegët dhe klientët.

## **III. Kërkesat e pranimit në Kursin “Sisteme të thata në ndërtesa”.**

Pjesmarrësit në Kursin “Sisteme të thata në ndërtesa” duhet të jenë mbi 16 vjeç, të kenë përfunduar arsimin e detyruar.

## **IV. Kohëzgjatja e Kursit “Sisteme të thata në ndërtesa”**

360 orë mësimore, ku

1 orë mësimore = 45 minuta

## V. Modulet e Kursit “Sisteme të thata në ndërtesa”.

Nr	Titulli i Modullit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet Mësimore
1	Hyrje në profesionin e punonjësit të sistemeve të thata në ndërtesa	MK-02-225-20	30 orë mësimore  Rekomandohet: 80% Teori 10% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të punonjësit të sistemeve të thata në ndërtesa.</li> <li>2. Kursanti përshkruan materialet e sistemeve të thata në ndërtesa.</li> <li>3. Kursanti përshkruan mjedisin dhe mjetet e punës për sistemet e thata në ndërtesa.</li> <li>4. Kursanti interpreton vizatime të thjeshta për punimet në sistemet e thata në ndërtesa.</li> </ol>
2	Punime të ndryshme në sistemet e thata	MK-02-226-20	80 orë mësimore  Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kursanti bën matjet për pozicionimin e strukturës.</li> <li>2. Kursanti përzgjedh dhe llogarit bazën materiale.</li> <li>3. Kursanti realizon punime të prerjes së materialit.</li> <li>4. Kursanti realizon punime të përshtatjes dhe bashkimit të elementeve.</li> <li>5. Kursanti realizon punime të krijimit të strukturës metalike.</li> <li>6. Kursanti realizon punime në pllaka të jashtme dhe të brendshme.</li> </ol>
3	Punime të montimit/zmontimit të tavaneve dhe mureve të thata me konstruksion metalik	MK-02-227-20	80 orë mësimore  Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kursanti kryen punimet përgatitore.</li> <li>2. Kursanti kryen montim-zmontimin e konstruksionit metalik tek dhe dopio, të mureve prej gipsi.</li> <li>3. Kursanti kryen montim-zmontimin e shtresave izoluese në muret e thatë.</li> <li>4. Kursanti kryen montim-zmontimin e murit të gipsit me konstruksion metalik</li> <li>5. Kursanti kryen montim-zmontimin e sistemeve metalike të tavaneve prej gipsi.</li> <li>6. Kursanti kryen montim-zmontimim e bashkimeve në tavan, dysheme dhe ngushtime të murit prej gipsi.</li> </ol>

4	Punime ndërtimi për tavane dhe fasada dekorative prej gipsi	MK-02-228-20	90 orë mësimore  Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kursanti kryen punime përgatitore për tavane dhe fasada prej gipsi..</li> <li>2. Kursanti kryen punime në tavanin e objektit.</li> <li>3. Kursantit kryen punime në fasadën dekorative të objektit.</li> <li>4. Kursanti monton profilet metalike të strukturës në fasadë dhe tavan.</li> <li>5. Kursanti realizon hapje të faqeve në muret e thata.</li> <li>6. Kursanti monton materialin izolues termik/akustik,</li> <li>7. Kursanti vendos materialin e gatshshëm prej gipsi dekorativ mbi sipërfaqe.</li> <li>8. Kursanti stukon bashkimin e pllakave të gipsit.</li> <li>9. Kursanti lyen sistemet e thata.</li> </ol>
5	Punime të mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemeve të thata në ndërtesa	MK-02-229-20	80 orë  Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kursanti analizon sistemin e thatë që ka nevojë për mirëmbajtje dhe riparim.</li> <li>2. Kursanti kryen mirëmbajtjen dhe riparimet e mundshme.</li> <li>3. Kursanti plotëson dokumentacionin teknik dhe financiar në punimet e sistemeve të thata në ndërtesa.</li> </ol>

## VI. Vlerësimi dhe Çertifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha Rezultatet Mësimore që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në Provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Çertifikatën përkatëse që njihet nga MFE.

## VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit për “Sisteme të thata në ndërtesa”

### 1. Moduli “Hyrje në profesionin e punonjësit të sistemeve të thata në ndërtesa ”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	HYRJE NE PROFESIONIN E PUNONJËSIT TË SISTEMEMEVE TË THATA NË NDERTESA	MK-02-225-20
<b>Qëllimi i modulit</b>	Një modul që i njeht kursantët me veçoritë e profesionit të punonjësit të sistemeve të thata në ndërtesa, me funksionet, detyrat dhe veprimtaritë ku mbështetet, materialet dhe mjetet e punës, si dhe i aftëson ata për të interpretuar vizatime teknike për sistemet e thata në ndërtesa.	
<b>Kohëzgjatja e modulit</b>	30 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori; 10% Praktikë; 10% Vlerësime	
<b>Niveli i parapëlqyer për pranimit</b>	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 16 vjeç	
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit</b>	<p><b>RM 1 Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të punonjësit të sistemeve të thata në ndërtesa</b>  <b>Kriteret e vlerësimit:</b>                      Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të përshkruajë funksionet, detyrat dhe veprimtaritë kryesore të punës së punonjësit të sistemeve të thata në ndërtesa</li> <li>- të përshkruajë mjediset, mënyrën e organizimit dhe kushtet e punës së punonjësit të sistemeve të thata në ndërtesa</li> <li>- të përshkruajë mjetet, pajisjet dhe makineritë që përdor punonjësi i sistemeve të thata në ndërtesa</li> <li>- të tregojë organizimin e punës.</li> <li>- të përshkruajë kërkesat profesionale të punonjësit të sistemeve të thata në ndërtesa.</li> <li>- të tregojë mundësitë e punësimit të punonjësit të sistemeve të thata në ndërtesa</li> <li>- të përshkruajë mundësitë e karrierës profesionale të punonjësit të sistemeve të thata në ndërtesa</li> <li>- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit.</li> <li>- të përshkruajë rregullat e komunikimit në mënyrë etike me eprorët, kolegët dhe klientët.</li> </ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pyetje përgjigje me gojë.</li> <li>- Pyetje përgjigje me shkrim.</li> </ul>	
	<p><b>RM 2 Kursanti përshkruan materialet e sistemeve të thata në ndërtesa</b>  <b>Kriteret e vlerësimit:</b>                      Kursanti duhet të jetë i aftë :</p>	

- të përdor terminologjinë teknike të ndërtesës
- të lexoj dhe interpretoj vizatimet teknike të ndërtesave
- të përdorë dokumentacionin teknik të ndërtesës
- të identifikojë elementet e ndërtimit të një ndërtese,
- të organizoj vendin e punës në përputhje me rregullat e qëndrueshmërisë dhe sigurisë,
- të sigurojë transportimin e duhur të materialeve të ndërtimit,
- të përdori burime të ndryshme informacioni.
- të identifikoj pllaka gipsi (letra të thata) të bazuara në letër të përdorura në sistemet e mureve të thata,
- të identifikojë pllakat e fibrave të gipsit të përdorura në Teknologjinë e Sistemeve të murit të Brendshëm,
- të identifikojë profilet e çelikut të përdorura në Teknologjinë e Sistemeve të mureve të Brendshëm,
- të identifikojë komponentët e ndërtimit të përdorur në Teknologjinë e Sistemeve të murit të Brendshëm
- të identifikoj materialet izoluese të përdorura në Teknologjinë e Sistemeve të murit të Brendshëm
- të identifikojë vetitë fizike, kimike dhe mekanike të pllakave të gipsit të përdorura në sistemet e thata
- të specifikojë parametrat e pllakave të gipsit të përdorura
- të specifikojë parametrat e profileve të çelikut të përdorura në sisteme të murit të thatë.
- të zbatojë metodat e kontrollit të cilësisë,
- të përcaktojë zbatimin e duhur të materialeve të përdorur
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

**RM 3 Kursanti përshkruan mjedisin dhe mjetet e punës për sistemet e thata në ndërtesa.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të klasifikojë veglat dhe pajisjet, mjetet e punës në përputhje me udhëzimet e prodhuesit.
- të tregojë përdorimin e veglave dhe pajisjeve për prerjen e gipsit.
- të përshkruajë procesin e fiksimit të upave në mura, tavan.
- të klasifikojë veglat dhe pajisjet për prerjen, montimin.
- të tregojë ndërtimin dhe përdorimin e veglave dhe pajisjeve për prerje.
- të përshkruajë procesin e prerjes.
- të klasifikojë veglat dhe pajisjet për vendosjen e rrjetës,
- të tregojë ndërtimin dhe përdorimin e veglave dhe pajisjeve për rrjetën.
- të përshkruajë procesin e vendosjen e rrjetës.
- të klasifikojë veglat dhe pajisjet për stukimin.
- të tregojë ndërtimin dhe përdorimin e veglave dhe

- pajisjeve për stukimin.
- të përshkruajë procesin e stukimit
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim

**RM 4 Kursanti interpreton vizatime të thjeshta për punimet në sistemet e thata në ndërtesa.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të dallojë standardet, simbolet, shenjat në vizatimin teknik.
- të zbatojë standardet bazë në vizatim teknik.
- të interpretojë përmasat kuotuese të vizatimeve.
- të lexojë dhe interpretojë tolerancat e paraqitura në vizatime teknike.
- të rendisë llojet e përmasave të pjesëve të makinave industriale.
- të shpjegojë konceptet bazë të tolerancave.
- të interpretojë tolerancat sipas sistemit ISO.
- të interpretojë tolerancat e paraqitura në vizatime teknike.
- të zbatojë tolerancat në dokumentacion teknik
- të lexojë dhe interpretojë shenjat e cilësisë së përpunimit të sipërfaqes së detaleve
- të skicojë vizatime të thjeshtuara dhe skematike të transmetuesve dhe impianteve hidrauliko-pneumatik.
- të skicojë vizatime të detaleve dhe nyjeve të thjeshta makinerike.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në laboratorë dhe në mjediset e punës.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës. Atyre duhet t'i jepen detyra të përshkruajnë veçoritë e profesionit të punonjësit të sistemeve të thata, me funksionet, detyrat dhe veprimtaritë ku mbështetet puna e tyre. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriteve të realizimit të specifikuara për



---

çdo rezultat të të mësuarit.

---

**Kushtet e  
e domosdoshme  
për realizimin e  
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
- Mjedise reale të punës për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e sistemeve të thata.
- Komplet i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e sistemeve të thata.
- Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

---

## 2. Moduli “Punime të ndryshme në sistemet e thata”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PUNIME TË NDRYSHME TË SISTEMEVE THATA	MK-02-226-20
<b>Qëllimi i modulit</b>	Një modul që i aftëson kursantët për të realizuar punime të ndryshme që kryhen në sistemet e thata në ndërtesa, me përdorimin e veglave të punës së dorës dhe të instrumentave matëse dhe kontrolluese.	
<b>Kohëzgjatja e modulit</b>	80 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
<b>Niveli i parapëlqyer për pranim</b>	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e punonjësit të sistemeve të thata në ndërtesa”.	
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit</b>	<p><b>RM 1 Kursanti bën matjet për pozicionimin e strukturës.</b> <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të tregojë llojet e matjeve të përmasave.</li><li>- të përzgjedhë drejt instrumentat matëse dhe shënuese.</li><li>- të realizojë matje të sakta me metër.</li><li>- të realizojë matje të sakta me kalibër.</li><li>- të realizojë prerje të sakta me sharrë.</li><li>- të realizojë matje të sakta me lazër, shirit nivelues</li><li>- të realizojë shënimet e nevojshme me instrumenta shënuese të llojeve të ndryshme.</li><li>- të kujdeset për instrumentat matëse dhe shënuese.</li><li>- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë matjeve të strukturës.</li></ul> <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Pyetje përgjigje me gojë.</li><li>- Vëzhgimi me listë kontrolli.</li></ul>	
	<p><b>RM 2 Kursanti përzgjedh bazën materiale.</b> <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Kursanti duhet të jetë i aftë :</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të interpretojë drejt skicën ose vizatimin e strukturës.</li><li>- të konsultohet me klientin për materialet që do të përdoren.</li><li>- të përcaktojë drejt procedurat që do të realizohen.</li><li>- të përcaktojë llojet e materialeve që do të përdoren.</li><li>- të përcaktojë sipas llogaritjeve llojin e materialit që do të përdoret.</li><li>- të zbatojë teknikat e duhura për llogaritjen e sipërfaqeve të rrafshta.</li><li>- të zbatojë teknikat e duhura për llogaritjen e sipërfaqeve cilindrike.</li><li>- të zbatojë teknikat e duhura për llogaritjen e sipërfaqeve të profiluara</li><li>- të zbatojë teknikat e duhura për llogaritjen e sipërfaqeve</li></ul>	

- me kënd
- të realizojë matje dhe shënime të sakta të sipërfaqeve përkatëse.
- të përcaktojë sasi të materialeve të përzgjedhura.
- të kujdeset për instrumentat matëse.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë matjeve dhe llogaritjes së sipërfaqes

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe me shkrim.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

**RM 3 Kursanti realizon punime të prerjes së materialit.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të analizojë drejt skicën e vizatimit të sisteme të thata
- të përzgjedhë drejt materialin që do të pritët.
- të përzgjedhë metodën e duhur për prerjen e pllakave Knauf.
- të përzgjedhë drejt veglat e punës, profilet dhe aksesoret.
- të përzgjedhë instrumentet e nevojshme matëse dhe shënuese.
- të zbatojë procedurat e vendosjes dhe shtrëngimit të pllakës në pajisjen mbajtëse.
- të zbatojë teknikat e duhura për prerjen me sharrë
- të zbatojë teknikat e duhura për prerjen me gërrshërë për fletë metalike.
- të zbatojë teknikat e duhura për prerjen me gërrshërë të profileve.
- të zbatojë teknikat e duhura për prerjen me gur-fleksibël.
- të realizojë matje dhe shënime të sakta gjatë prerjes.
- të zbatojë procedurat e lidhjes së profileve në vrima.
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

**RM 4 Kursanti realizon punime të përshtatjes dhe bashkimit të elementeve.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të analizojë drejt skicën e vizatimit të konstruksonit (në mur apo tavan).
- të përzgjedhë drejt llojin e materialit, sipas trashësisë, cilësisë, përbërjes dhe funksionit.
- të përzgjedhë drejt veglat e punës.
- të vlerësojë cilësinë e prerjes së materialit
- të zbatojë procedurat e vendosjes dhe shtrëngimit të materialit në profilet metalike.
- të realizojë bashkimin e duhur të pllakave të sistemeve të

thata.

- të realizojë matje dhe kontrolle të sakta për cilësinë e bashkimit të pllakave knauf.
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës.
- të mirëmbajë pajisjen për prerjen e materialit knauf, profileve metalike.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të prerjeve

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli

**RM 5 Kursanti realizon punime të krijimit të strukturës metalike.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të analizojë drejt skicën e vizatimit të strukturës së sistemeve të thata
- të përzgjedhë drejt profilet metalike për ndërtimin e strukturave.
- të përzgjedhë mënyrën e duhur të përforcimit që të sigurohet qëndrueshmëria e strukturës.
- të përzgjedhë drejt veglat e punës.
- të përzgjedhë instrumentet e nevojshme matëse, shpues dhe shënuese.
- të zbatojë procedurat e vendosjes, shënjimit dhe shpimit të materialve dhe strukturave mbajtëse.
- të zbatojë teknikat e duhura për punimin e materialit (knauf) me anë të përkuljes me vegla dore.
- të zbatojë teknikat e duhura për punimin e materialit (kauf) me anë të shtypjes (rrahjes) me vegla dore.
- të zbatojë teknikat e duhura për punimin e profileve prej fletësh metalike me anë të kthimit, palosjes dhe lidhjes së fletëve.
- të realizojë matje dhe shënime të sakta gjatë punimit të vendosjes së materialeve termoizoluese për përmirësimin e vetive akustike.
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të krijimit të strukturës metalike.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

**RM 6 Kursanti realizon punime në pllaka të jashtme dhe të brendëshme.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të analizojë drejt skicën e vizatimit të punimeve në pllakat e sistemeve të thata.
- të përcaktojë drejt mënyrën dhe parametrat e profilit të

brendshëm ose të jashtëm.

- të përzgjedhë drejt instrumentat dhe pajisjet për hapjen.
- të përzgjedhë instrumentat e duhur për matje dhe shënim.
- të zbatojë procedurat e vendosjes dhe shtrëngimit siç duhet të pllakës në mbajtësen e profileve metalike.
- të realizojë shpimet e nevojshme në pllakë, për hapjen e brendëshme.
- të realizojë përgatitjen e pajisjeve të dorës për hapjen.
- të realizojë përgatitjen e copës për hapjen.
- të zbatojë teknikat dhe kalimet e punimit gjatësor dhe tërthor të hapjes së jashtme.
- të realizojë largimin e mbetjeve.
- të realizojë matje dhe shënime të sakta.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknike e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve me pajisje dore.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në reparte të sistemeve të thata ose mjedise pune ku kryhen punime të ndërtimit.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të punimeve kryesore të sistemeve të thata.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Kursantët duhet të angazhohen në demonstrime për përfitimin e shkathtësive praktike për ndërtimin dhe vënien në punë të mbikqyrjes respektimin e rregullave të mbrojtjes në punë, ruajtjes së mjedisit dhe mirembajtjes së veglave dhe pajisjeve.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedise të praktikës së sistemeve të thata.
  - Komploti i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për matje, shënime dhe procese pune të sistemeve të thata.
  - Pllaka të ndryshme knaufi për punime të sistemeve të thata
  - Elemente të strukturave dhe aksesorë
  - Skica dhe vizatime teknike të detaleve të ndryshme.
  - Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

### 3. Moduli “Punime të montim/zmontimit të tavaneve dhe mureve të thata me konstruksion metalik”.

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PUNIME TË MONTIM/ZMONTIMIT TË TAVANEVE DHE MUREVE TË THATA ME KONSTRUKSION METALIK	MK-02-227-20
<b>Qëllimi i modulit</b>	Një modul që i aftëson kursantët për të bërë montimin dhe zmontimin e konstruksionit metalik, nyjeve, hapjeve të sistemeve të thata si dhe të bëjë kontrollin dhe matjet e nevojshme.	
<b>Kohëzgjatja e modulit</b>	80 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
<b>Niveli i parapëlqyer për pranim</b>	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulin “Hyrje në profesionin e punonjësit të sistemeve të thata në ndërtesa”.	
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit</b>	<p><b>RM 1 Kursanti kryen punimet përgatitore.</b>  <b>Kriteret e vlerësimit:</b>            Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– të analizojë drejt dokumentacionin teknik të konstruksionit metalik.</li> <li>– të analizojë drejtë skemën e mureve të sistemeve të thata.</li> <li>– të përcaktojë saktë rrugën operacionale të montim-zmontimit të konstruksionit metalik, nyjeve etj.</li> <li>– të përzgjedhë veglat, pajisjet instrumentat matës, kontrollues.</li> <li>– të organizojë dhe të përgatisë vëndin e punës për realizimin e zmontimit.</li> <li>– të realizojë zmontim e konstruksionit metalik: në profile, nyje.</li> <li>– të realizojë zmontimin e brinjëve gjatësore, ballore, bashkimin e pllakave mbi profil</li> <li>– të realizojë fiksimin anash profilit, në dy krah etj.</li> <li>– të zbatoj rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.</li> </ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Pyetje përgjigje me gojë.</li> <li>– Vëzhgimi me listë kontrolli.</li> </ul> <p><b>RM 2 Kursanti kryen montim/zmontimin e konstruksionit metalik tek dhe dopio, të mureve prej gipsi</b>  <b>Kriteret e vlerësimit:</b>            Kursanti duhet të jetë i aftë :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– të interpretojë drejt vizatimin e konstruksionit metalik tek</li> <li>– të analizojë skemën e funksionimit të nyjeve të konstruksionit tek dhe dopio metalik.</li> <li>– të përcaktojë saktë rradhën operacionale të montim-zmontimit të profileve, upave, për ndërtimin e dyerve dhe</li> </ul>	

- konstruksioneve mbajtëse.
- të përzgjedhë drejt veglat, paisjet e instrumentat matës dhe kontrollues.
  - të organizojë dhe të përgatisë vëndin e punës për kryerjen e montim-zmontimit.
  - të vendosë në pajisjen e montim-zmontimit nyjen përkatëse.
  - të realizojë zmontimin e sistemeve, hapjeve të brendëshme dhe të jashtme.
  - të realizojë matjet dhe kontrollin e elementëve përbërës të sistemeve së konstruksionit metalik.
  - të realizojë zëvëndësimin e elementëve të konsumuar apo të difektuar.
  - të realizojë montimin e elementëve të sistemeve.
  - të zbatojë procedurat e heqjes së sistemeve nga pajisja e montim-zmontimit.
  - të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës.
  - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të montim-zmontimit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

**RM 3 Kursanti kryen montim-zmontimin e shtresave izoluese në muret e thatë.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të interpretojë drejt vizatimin e sistemeve të mureve të thata.
- të analizojë skemën e funksionimit të sistemeve të thata.
- të përcaktojë saktë rradhën operacionale të montimit të shtresës izoluese në mure të thata.
- të përzgjedhë drejt instrumentat matës dhe kontrollues.
- të vendosë në pajisjen e montimit shtresën izoluese (pambuk mineral).
- të realizojë matjet dhe kontrollin e elementëve përbërës të strukturës me shtresë izoluese.
- të realizojë zëvëndësimin e elementëve të konsumuar apo të difektuar.
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të montim-zmontimit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

**RM 4 Kursanti kryen montim-zmontimin e murit të gipsit me konstruksion metalik**

***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të interpretojë drejt vizatimin e murit prej kanufi.

- të analizojë skemën e funksionimit të murit
- të përcaktojë saktë rradhën operationale të montim-zmontimit të konstruksionit metalik të murit
- të përzgjedhë drejt instrumentat matës dhe kontrollues.
- të organizojë dhe të përgatisë vëndin e punës për kryerjen e montim-zmontimit.
- të vendosë në pajisjen e montim-zmontimit strukturën përkatëse metalike.
- të realizojë zmontimin e pllakës nga profilet.
- të kryejë matjet dhe kontrollin e elementëve përbërës të murit.
- të realizojë zëvëndësimin e elementëve të konsumuar apo të difektuar.
- të realizojë montimin e elementëve të sistemeve së mureve me trashësi të ndryshme.
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të montim-zmontimit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

**RM 5 Kursanti kryen montim-zmontimin e sistemeve metalike të tavaneve prej gipsi.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të interpretojë drejt vizatimin e sistemeve .
- të analizojë skemën e funksionimit të sistemeve metalike tavanore.
- të përcaktojë saktë rradhën operationale të montim-zmontimit të sistemeve.
- të përzgjedhë drejt instrumentat matës dhe kontrollues.
- të përzgjedhë drejt veglat dhe pajisjet e punës për montim-zmontim.
- të organizojë dhe të përgatisë vëndin e punës për realizimin e montim-zmontimit.
- të vendosë në pajisjen e montim-zmontimit nyjen përkatëse.
- të realizojë zmontimin e sistemeve.
- të realizojë matjet dhe kontrollin e elementëve përbërës të sistemeve.
- të realizojë zëvëndësimin e elementëve të konsumuar apo të difektuar.
- të realizojë montimin e elementëve të sistemeve.
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të montim-zmontimit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.



**RM 6 Kursanti kryen montim-zmontim e bashkimeve në tavan, dysHEME dhe ngushtime të murit prej gipsi.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të interpretojë drejt vizatimin e sistemeve përkatëse.
- të analizojë skemën e funksionimit të sistemeve për bashkimin në tavan, dysHEME.
- të përcaktojë saktë rradhën operacionale të montim-zmontimit të bashkimit në tavan dhe dysHEME
- të përzgjedhë drejt instrumentat matës dhe kontrollues.
- të organizojë dhe të përgatisë vëndin e punës për realizimin e montim-zmontimit.
- të përcaktojë saktë rradhën operacionale të montim-zmontimit të ngushtimit të murit
- të realizojë zmontimin e sistemeve.
- të realizojë matjet dhe kontrollin e elementëve përbërës të sistemeve.
- të realizojë zëvendësimin e elementëve të konsumuar apo të difektuar.
- të realizojë montimin e elementëve të sistemeve.
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të montim-zmontimit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e montim-zmontimit ose mjedise pune ku kryhen punime të montim-zmontimit të konstruksioneve metalik të sistemeve të thata.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të punimeve kryesore të montim-zmontimit të konstruksioneve metalike në tavan, dysHEME dhe mure.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Kursantët duhet të angazhohen në demonstrime për përfitimin e shkathtësive praktike për montim-zmontim e sistemeve të thata, të mbikqyrë respektimin e rregullave të mbrojtjes në punë, ruajtjes së mjedisit dhe mirembajtjes së veglave dhe pajisjeve.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

---

**Kushtet e  
e domosdoshme  
për realizimin e  
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedise të praktikës së montim-zmontimit të sistemeve të thata
- Komplet i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për montim-zmontim e sistemeve të thata
- Materiale pune dhe aksesore
- Konstruksionet metalike teke dhe dopio për muret, tavanet, dyshemtë, profilet të ndryshme, etj.
- Projekte të sistemeve të thata, vizatime të nyjeve, skema të montim-smontimit, shtresat izoluese, kutitë elektrike etj.
- Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

---

#### 4. Moduli “Punime ndërtimi për tavane dhe fasada dekorative prej gipsi”.

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	<b>PUNIME NDËRTIMI PËR TAVANE DHE FASADA DEKORATIVE PREJ GIPSI</b>	<b>MK-02-228-20</b>
<b>Qëllimi i modulit</b>	Një modul që aftëson kursantët për të kryer punimet e ndërtimit prej gipsi për tavane dhe fasada dekorative, me lloje të ndryshme të materialeve e të profileve, të bëjë klasifikimin e tyre dhe vendosjen e materialeve të gatshme prej gipsi dekorues duke i stukuar ato.	
<b>Kohëzgjatja e modulit</b>	90 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
<b>Niveli i parapëlqyer për pranim</b>	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e punonjësit të sistemeve të thata në ndërtesa”.	
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit</b>	<p><b>RM 1 Kursanti kryen punime përgatitore për tavane dhe fasada prej gipsi.</b>  <b>Kriteret e vlerësimit:</b>            Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– të analizojë objektin ku do të kryhen punime ndërtimi për tavane dhe fasada prej gipsi.</li> <li>– të analizojë skicat ose vizatimet e detajeve të tavanit dhe fasadës prej gipsi.</li> <li>– të analizojë drejtë gjendjen e tavaneve dhe të fasadës</li> <li>– të analizojë drejtë realizimin e skemës së profileve metalike.</li> <li>– të bëjë matje dhe shënime për pozicionimin e dekorimeve sipas skicës.</li> <li>– të përcaktojë mënyrat kryesore të realizimit të detajeve për instalimin e elementeve dekoruese.</li> <li>– të pastrojë pjesët anësore të paneleve me thikë, zdrukth apo mjete të tjera për të siguruar që bashkimet janë të drejta</li> <li>– të shënojë vijat e prerjes mbi panele apo pllaka gipsi me mjete shënjuese sipas kushteve teknike të projektit.</li> <li>– të presë pllakat e gipsit sipas kushteve teknike të projektit</li> <li>– të smusojë pllakat e gipsit sipas kushteve teknike të projektit.</li> <li>– të montojë pllakat e gipsit në strukturën metalike sipas projektit dhe sipas kushteve teknike</li> <li>– të vendosë siç duhet rrjetën në pikat e bashkimit midis pllakave të gipsit</li> <li>– të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit</li> </ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Pyetje përgjigje me gojë.</li> <li>– Vëzhgimi me listë kontrolli.</li> </ul>	

## **RM 2 Kursanti kryen punime në tavanin e objektit.**

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të analizojë vizatimin e detajit dekorativ dhe pozicionimin e tij.
- të përzgjedhë drejt instrumentat matës dhe kontrollues.
- të përzgjedhë drejt instrumentat dhe veglat e punës.
- të fiksojë elementët mbërthyes të strukturës metalike në tavan,
- të vendosë profilet metalike të strukturës në mure
- të vendosë elementët horizontalë metalikë të tavanit
- të vendosë kapëset bashkuese në pikat e kryqëzimit të profileve.
- të kryejë nivelimin e strukturës metalike mbajtëse.
- të vendosë profilet në pikat e bashkimit të tavaneve të gipsit me sipërfaqe të tjera
- të instalojë profilet në fugat konstruktive të objektit sipas projektit
- të vendosë materialin izolues për izolimin termik/akustik
- të vendosë pllakat e gipsit
- të bëjë hapjen e vrimave për instalimin e ndriçueseve ose instalimeve të tjera
- të instalojë, sipas rasteve dritaret e kontrollit bazuar në projekt
- të zbatojë rregullat e sigurimit të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

## **RM 3 Kursanti kryen punime në fasadën dekorative të objektit.**

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të analizojë vizatimin e detajit dekorativ dhe pozicionimin e tij.
- të përzgjedhë drejt instrumentat matës dhe kontrollues.
- të përzgjedhë drejt instrumentat dhe veglat e punës.
- të fiksojë elementët mbërthyes të strukturës metalike në fasadë,
- të vendosë profilet metalike të strukturës në mure
- të vendosë elementët horizontalë metalikë të tavanit
- të vendosë kapëset bashkuese në pikat e kryqëzimit të profileve
- të kryejë nivelimin e strukturës metalike mbajtëse
- të vendosë profilet në pikat e bashkimit të tavaneve të gipsit me sipërfaqe të tjera
- të instalojë profilet në fugat konstruktive të objektit sipas projektit
- të vendosë materialin izolues për izolimin termik/akustik
- të vendosë pllakat e gipsit
- të bëjë hapjen e vrimave për instalimin e ndriçueseve ose

- instalimeve të tjera
- të instalojë, sipas rasteve dritaret e kontrollit bazuar në projekt
- të zbatojë rregullat e sigurimit të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli

**RM 4 Kursanti monton profilet metalike të strukturës në fasadë dhe tavan.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të analizojë skicën ose vizatimin e dekorimit dhe pozicionin e vendosjes së tyre.
- të përzgjedhë drejt instrumentat matës dhe veglat e punës
- të sigurojë cilësinë e materialit të përdorur sipas standardeve përpara montimit.
- të realizojë saktë procesin e montimit.
- të realizojë saktë kontrollin dhe matjet me instrumentat përkatëse.
- të tregojë kujdes për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë montimit të dekoreve.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

**RM 5 Kursanti realizon hapje të faqeve në muret e thata.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të analizojë drejt skicën ose vizatimin e pozicionimit të dekoreve.
- të përzgjedhë drejt veglat dhe instrumentat e punës.
- të kryejë saktë matjet dhe të bëj shënimet në strukturë ku do të hapet dritare, derë, kutitë elektrike etj.
- të përcaktojë saktë elementët: gjatësi, gjerësi, thellësi për të përdorur elementët e nevojshëm mbyllës profile metalike.
- të realizojë saktë procesin e lidhjes së profileve dhe konstruksionit metalik me pjesët e tjera të objektit.
- të realizojë saktë transportin dhe montimin e dekoreve në pozicionet e kërkuara.
- të tregojë kujdes për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

**RM 6 Kursanti monton materialin izolues termik/akustik.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të analizojë drejt skicën ose vizatimin e detajit të materialit izolues.
- të realizojë zgjedhjen e duhur të mjeteve të punës në varësi të llojit të materialit dhe sipërfaqes në të cilën do të aplikohet.
- të përzgjedhë drejt instrumentat matës dhe kontrollues.
- të kryejë saktë matjet dhe kontrollet me instrumentat përkatëse.
- të përcaktojë saktë llojin / klasën e materialit izolues termik/akustik që do përdoret.
- të realizojë saktë procesin e vendosjes së materialit izolues në konstruksionin me profile të ndërtuar për këtë qëllim.
- të realizojë saktë procesin e montimit.
- të tregojë kujdes për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

**RM 7 Kursanti vendos materialin e gatshshëm prej gipsi dekorativ mbi sipërfaqe.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të analizojë skicën ose vizatimin e dekorit
- të përcaktojë drejt pozicionimin materialeve
- të përzgjedhë drejt instrumentat dhe veglat e punës për përgatitjen e bazës së shtresave të gipsit.
- të realizojë zgarën metalike me profile.
- të realizojë saktë procesin e shtrimit të bazës së gipsit.
- të realizojë saktë procesin e stukimit me mjete.
- të tregojë kujdes për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë procesit të shtrimit, stukimit dhe fërkimit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

**RM 8 Kursanti stukon bashkimin e pllakave të gipsit**

***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të analizojë mënyrën e aplikimit të materialit mbushës
- të përzgjedhë drejt instrumentat dhe veglat e punës.
- të realizojë vendosjen e rrjetës nëse ka largësi midis gipseve.
- të realizojë saktë procesin shtrimit, stukimit dhe fërkimit.

- të tregojë kujdes për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

**RM 9 Kursanti lyen sistemet e thata**

***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të analizojë punën e realizuar të gipseve
- të përcaktojë drejt nëse materiali nuk ka nevojë për stukime të mëtejshme.
- të përzgjedhë drejt instrumentat dhe veglat e punës për lyerjen e gipsit.
- të realizojë përgatitjen e materialit për lyerjen.
- të realizojë saktë procesin e lyerjes me mjetet e duhura
- të llogaritë koston dhe çmimin e punimit të kryer.
- të tregojë kujdes për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë procesit të lyerjes me dorë.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e montimit ose mjedisë pune ku kryhen punime të montimit të konstruksioneve metalik të sistemeve të thata
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të punimeve kryesore të montimit të dekoreve në mure, tavane, fasada më përbërje të sistemeve të thata ose në materiale të tjera, si dhe realizimin e hapjeve në brendësi apo dhe jashtë saj.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të stukimeve, bashkimeve e smerilimeve.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Kursantët duhet të angazhohen në demonstrime për përfitimin e shkathtësive praktike për montim e dekoreve të sistemeve të thata, të mbikqyrë respektimin e rregullave të mbrojtjes në punë, ruajtjes së mjedisit dhe mirembajtjes së veglave dhe pajisjeve.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

---

**Kushtet e  
e domosdoshme  
për realizimin e  
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedise të praktikës së ndërtimit të mureve, tavaneve, fasadave dekoruese, në objekt.
- Komplet i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për matje, shënime dhe procese pune të kartonxhesit.
- Materiale pllaka gipsi, materiale stuko, profile metalike
- Skica dhe vizatime teknike të ndryshme, pajisjeve dhe makineri për realizimin e proceseve.
- Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

---



## 5. Moduli “Punime të mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemeve të thata në ndërtesa”.

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
<b>Titulli dhe kodi</b>	<b>PUNIME TË MIRËMBAJTJES DHE RIPARIMIT TË SISTEMEVE TË THATA NË NDËRTESEA</b>	<b>MK-02-229-20</b>
<b>Qëllimi i modulit</b>	Një modul që i aftëson kursantët për të realizuar punime të ndryshme të mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemeve të thata në ndërtesa, plotësimin e dokumentit teknik dhe financiar për punimet e sistemeve të thata në ndërtesa.	
<b>Kohëzgjatja e modulit</b>	80 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
<b>Niveli i parapëlqyer për pranim</b>	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e punonjësit të sistemeve të thata në ndërtesa”.	
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit</b>	<p><b>RM 1 Kursanti analizon sistemin e thatë që ka nevojë për mirëmbajtje dhe riparime.</b> <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të analizojë objektin dhe sistemin e thatë që ka nevojë për mirëmbajtje dhe riparim.</li> <li>- të analizojë skicën ose vizatimin e sistemit të thatë, që do të mirëmbahet, riparohet nga ana konstruktive.</li> <li>- të analizojë udhëzuesit e materialit, pozicionin e vendosjes, sistemet konstruktive që do të mirëmbahen.</li> <li>- të përcaktojë llojin e ndërhyrjes që do realizohet në sistemin e thatë.</li> <li>- të përcaktojë vendet dhe llojin e kontrollit të mureve të thata.</li> <li>- të përcaktojë drejt instrumentat dhe pajisjet e kontrollit të mureve të thata.</li> <li>- të tregojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë shërbimit të mirëmbajtjes, riparimit të sistemeve të thata.</li> </ul> <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Pyetje përgjigje me gojë.</li> <li>– Vëzhgimi me listë kontrolli.</li> </ul> <p><b>RM 2 Kursanti kryen mirëmbajtjen dhe riparimet e mundshme.</b> <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– të përcaktojë drejt llojet e punimit dhe shtresat që duhen për të kryer procesin e bashkimit, stukimit etj.</li> <li>– të përzgjedhë materialet e nevojshme për riparimet dhe mirëmbajtjen.</li> <li>– të kryejë punimet e mirëmbajtjes së sistemit të thatë.</li> </ul>	

- të kryejë punimet e riparimit të sistemit të thatë.
- të realizojë saktë procesin e bashkimit, stukimit etj.
- të realizojë saktë kontrollin dhe matjet me instrumentat përkatës.
- të tregojë kujdes për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë mirëmbajtjes dhe riparimit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

**RM 3 Kursanti plotëson dokumentacionin teknik dhe financiar për punimet e sistemeve të thata në ndërtesa.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të evidentojë te gjitha pjesët e zëvendësuara, riparuar dhe shërbimeve të kryera
- të regjistrojë të dhënat për faturat e lëshuara dhe të marra.
- të zbatojë legjislacionin tatimor të fushes lidhur me aktivitetin që kryen.
- të ruajë dhe arkivojë të gjithë dokumentacionin e hyrjes dhe daljes së mallit.
- të kontrollojë tregun e materialit lidhur me çmimet dhe cilësinë e tyre.
- të përgatisë ofertë për shërbimet e sistemeve të thata.
- të kryejë blerje të materialeve, mjeteve dhe veglave të punës sipas grafikut të punimeve.
- të hartojë preventivin e materialeve të përdorura për shërbimet në punimet e sistemeve të thata
- të llogarisë koston për materialet e përdorura.
- të llogarisë kohën e punës dhe koston e punës për shërbimet në punimet e sistemeve të thata
- të llogarisë koston e plotë dhe mimin e shërbimit.
- të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar të punimeve në sistemet e thata.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e mirëmbajtjes ose në reparte të tjera ku kryhen punime riparimit të sistemeve të thata
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të punimeve kryesore të mirëmbajtjes që realizohen.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve të mirëmbajtjes së strukturave metalike pllakave të gipsit, si dhe për plotësimin e dokumentacionit teknik dhe financiar për punimet e kryera. Ata duhet të nxiten të

---

diskutojnë në lidhje me proceset e punimit të mirëmbajtjes që realizojnë.

- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedise të praktikës te mirembajtjes.
  - Pajisje, makineri dhe konstruksione te ndryshme gipsi.
  - Komplet i veglave, pajisjeve dhe materialeve të punës për mirëmbajtje teknike.
  - Komplet i instrumenteve të nevojshme për matje dhe kontrolle teknike.
  - Skica dhe vizatime teknike (katallog).
  - Formate të dokumentacionit teknik dhe financiar.
  - Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të përdorura në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-